



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.525/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimiq dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Fryma e Re (FER), paraqitur kundër Bashkim Gashi komisioner nga rradhër e subjektit politik PDK-ës në fshatin Kiev komuna e Malishevës, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 15.12.2010, mori këtë:

VENDIM

HIDHET poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Fryma e Re (FER).

ARSYETIMI

Më datën 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik FER në të cilën theksohet se në fshatin Kiev komuna e Malishevës, sipas vëzhguesit të FER-it Qëndresa Gashi në QV 3034/12A pak para mbylljes së qendrës vendvotimit rreth orës 18:30 ka pasur tentativa për të votuar për herë të dytë nga militantët e PDK cilët me forcë kanë tentuar të hyjnë në sallë, por megjithatë ata janë ndaluar nga zyrtarë prezent.

Ne mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë prove materiale.

Neni 59.2 i LZP-së përcakton se:

KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 *Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e palejuar

PZAP-i vlerëson se ankesa e FER-it paraqitur kundër kryesuesit të vendvotimit është jashtë juridiksionit të PZAP, për shkak se rasti në fjalë nuk ka prodhuar pasoja juridike përfaktin se ankuesi nuk ka adresuar ndonjë shkelje eventuale të LZP-ës. Prandaj për këtë arsye dhe në pajtim të dispozitave ligjore të cekura më lartë si dhe në pajtim të nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrasa

A nr. 525/2010 më datën 15.12.2010

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

